



KOMUNA VUSHTRRI

KOMISIONI KOMUNAL I REGJISTRIMIT

Shpall

KONKURS PER PRANIMIN E REGJISTRUESVE NË PROJEKTIN E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË NË KOSOVË

Kriteret :

Të gjithë kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e mëposhtme mund të aplikojnë për punën e regjistruarit në projektin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë :

1. Të jetë banor i Kosovës, dhe të paraqes dëshminë e identitetit
2. Të ketë reputacion të mirë dhe të mos të jetë nën hetime
3. Të ketë kualifikim universitar, shkollën e lartë, përvojë në shërbime statistikore, për zona të caktuara, të kenë të kryer shkollimin e mesëm.
4. Të jetë banor i komunës-vendbanimit, ku pjesa më e madhe e detyrave është e përcaktuar
5. Të ketë aftësi për të folur dhe kuptuar gjuhën normale, në mënyrë të paktën një prej gjuhëve të kërkuara në konkurs (ju lutem përcaktoni gjuhët të cilat i flisni).
6. Të jetë i gatshëm të marrë pjesë në sesionet e trajnimeve.
7. Të jetë i lirë nga secila punë obligative për tërë periudhën e caktuar në regjistrim.
8. Të posedojë një telefon mobil.
9. E preferuar, të ketë leje për vozitje.
10. Të jetë i gatshëm të punojë me orar të zgjatur, të punojë edhe gjatë fundjavave.

Nuk merren në shqyrtim aplikacionet e kandidatëve të cilët:

- Janë të angazhuar në veprimtari aktive, fushata të partive politike, gjatë kohës së kryerjes së detyrës në regjistrim në periudhën brenda 24-orëve.
- Janë të punësuar si vlerësues të tatimeve, kontrollorë të tatimeve, oficerë doganash apo oficerë të zbatimit të ligjit.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Regjistruesit do të trajnohen nga kontrollorët. Regjistruesi është personi i cili bën mbledhjen e të dhënave për ekonomitë familjare me anë të pyetësorëve. Intervista zhvillohet drejtpërsëdrejti me anëtarët e ekonomive familjare duke i vizituar derë më derë.

Kohëzgjatja e punës

Punësimi do të zgjasë 1 muaj nga 20 Marsi deri më 20 Prill, 2011

Puna, Orët dhe Pagesa

Puna ditore e regjistrimit zakonisht kryhet brenda orarit prej 08:00 deri 20:00. Për të përmbushur afatet, regjistruesit duhet të jenë në dispozicion të punojnë edhe jashtë këtij orari, kohën kur personat që përgjigjen janë në shtëpi. Regjistruesit duhet të jenë të gatshëm për të të punuar veçanërisht gjatë fundjavave.

Ju do të paguheni me pagë bazë, varësisht prej shtrirjes së qarqeve regjistruese (urban, rural apo kodrinoro-malor) si dhe numrit të plotësuar të formularëve.

Trajnimi

Ju do të trajnoheni nga kontrollorët tuaj për 5 ditë, nga data 21 deri më 25 Mars 2011. Lokacioni i trajnimit do të jetë sa më afër qarkut regjistrues.

Tri ditë para fillimit të regjistrimit (29-30 Mars 2011), ju do të njiheni për së afërmi me qarkun tuaj regjistrues dhe do të leni letrat informuese dhe fletëpalosjet në ekonomitë familjare. Gjatë trajnimit nga ana e udhëheqësve tuaj, ju do të pajiseni me materialet e regjistrimit.

Procedurat e Aplikimit

Aplikacionet mund të shkarkohen (merren) në web faqen e ESK-së në link-un: <http://www.esk.ks-gov.net/> tek Njoftimet, **Rekos2011**, web faqet e komunave si dhe në formë të shtypur (printuar) apo në ndërtesën e kuvendeve komunale.

Aplikacionet dorëzohen në ndërtesën e kuvendeve komunale.

Konkursi është i hapur nga data 21 shkurt deri më 04 mars 2011.

Komuna e Vushtrrise

Komisioni Komunal i Regjistrimit

Adresa: Rruga ""Bedri Pejani"" SHMU afer stacionit te Policise

Komisioni Komunal i regjistrimit është një punëdhënës me mundësi të barabarta.